



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.11, date 15/07/2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES ME  
NR.SERIE 00091, MIRATUAR NGA KBU MAT ME VENDIMIN  
NR.3, DATË 26.07.2018 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR  
NËNTOKËSOR ME QËLLIM AMBALLAZHIMIN NË SHISHE  
OSE ENË, SUBJEKTIT “UJË PUKA” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor me qëllim amballazhimin në shishe ose enë me Nr.serie:00091, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.3, datë 26.07.2018, subjektit “Ujë Puka” sh.p.k, me NIPT (L79004301N) me vendndodhje, Njësia Administrative Fushë-Arrës, Qarku Shkodër, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

-  $X= 501440.63$ ;  $Y= 4658625.04$ ;  $Z= 535$  m;

- Prurja mesatare :  $Q_{mes}= 1.1$  l/s

- Sasia e ujit në përdorim :  $Q= 1.1$  l/s

- Qëllimi i përdorimit : Amballazhim në shishe ose enë

- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Në gropë septike

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

**KRYETARI I KBU MAT**

**GJERGJ PRENDI**

